

PKR.nr.102/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Musa Konxheli, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.267/14 te datës 08.05.2015, në praninë e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Shukri Jashari, të pandehurit A.M., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.18.10.2016, morri dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A.M.**, nga Ferizaj,” nr..., data e lindjes..., në të njëjtin vend, nga i ati H., e ëma K. e gjinisë P..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike,

ËSHTË FAJTOR

me dt. 23 nëntor 2014, rreth orës 03:10 në rr”Ahmet Kaçiku”, ka mbajtur në posedim të paautorizuar, armën “Ecol Special 99”, me numër serik EV 1341959, në atë mënyrë që deri sa ishte duke ecur rrugës ndalet nga ana e policisë dhe gjatë kontrollimit i është gjetur arma, me çrast e njëjta edhe i konfiskohet nga ana e policisë,

-me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 17,21,41,43,45,46, dhe 73 të KPK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së të pandehurin e :

G J Y K O N

Denim me gjobë në lartësi prej 300 € (tre qind euro) të cilën detyrohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Me kërkesën e të pandehurit dënimi me gjobë mund të paguhet edhe me këste mujore dhe atë jo me shume se 3 këste mujore nga plotëfuqishmeria e këtij aktgjykimi.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma Ecol Special me numër 1341959.

Në bazë të nen. 450 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.267/14 të datës 08.05.2015 ka ngarkuar të pandehurin A.M., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.10.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Shukri Jashari, mbeti në tërsi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri A.M. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza, në të gjitha pikat e saj dhe shton se është penduar thellë për këtë vepër penale dhe premton se nuk dot ë kryej vepra të tilla apo të ngjashme.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të

KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,

- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,

- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve i dt. 23.11.2014 si dhe shikimi i fotografive që gjenden në shkresat e lëndës

- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*)

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen tiparet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytësim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma Ecol Special me numër 1341959.

Konformë nen. 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, e cila është caktuar duke pasur parasyshë gjendjen ekonomike të pandehurit dhe komplikushmerinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA,
PKR.nr.102/15 e dt.18.10.2016**

Bashkëpunëtorja profesionale
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues,
Musa Konxheli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.